
 Republika e Kosovës	Drejtorati për Shëndetësi		 Komuna e Istogut
	Nr.45/2023	Data: 21.06.2023	

Në bazë të ligjit për Zyrëtarët Publikë Nr.06/L-114, Neni 67 dhe 68, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.04/2020, të Kujdesit Parësorë Shëndetësorë, Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr.03/L-212, neni 4 paragrafi 6, neni 5 i Udhëzimit Administrativë Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Neni 21, të statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 01 Nr.36/2016, i datës 30.03.2016 – Istog, dhe pas marrjes së autorizimit nga MAP/DASHC, Drejtoria për Shëndetësi shpallë këtë:

K O N K U R S T Ë B R È N D S H È M P Ë R P L O T È S I M I N E V E N D E V E T Ë L I R A T Ë P U N È S

Titulli i vendit të punës: Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare
Numri i Referencës: 45/2023
Numri i ekzekutuesve: 1 (një)
Lloji i pozitës: Jo i karrierës
Orari i plotë: 40 orë në javë
Kategoria Funktionale: Niveli drejtues
Grada: Niveli i koeficientit - H4 (12.5)
Kohëzgjatja e emërimit: Me mandat 4 vjeçar
Kohëzgjatja e periudhës provuese: 12 muaj

Qellimi i vendit të punës: Menaxhimi efikas i QKMF-së në mënyrë që të siguroj mbarëvajtje të punëve dhe shërbimeve në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe të siguroj shërbime cilësore të personelit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Është përgjegjës për të siguruar ligjëshmërinë në punë dhe afarizmin e QKMF-së si dhe për punët profesionale të QKMF-së, e cila duhet të organizohet dhe udhëhiqet në pajtim me aktet normative;
2. Është përgjegjës për Kujdesin Parësorë Shëndetësorë për të gjithë banorët e Komunës së Istogut;
3. Në pajtim me politikën shëndetësore, ligjin për shëndetësi të Kosovës dhe strategjinë për KPSH, i propozon për miratim Drejtoratit për Shëndetësi planin e punës dhe buxhetin e QKMF-së për vitin vijues;
4. Nën mbikëryje dhe autorizimin e drejtorit të D.SH. zbaton buxhetin e QKMF-së;
5. Është përgjegjës për zbatimin e planeve të burimeve njerëzore;
6. Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punëve në QKMF;
7. Është përgjegjës për zhvillimin e mardhënjeve të mira me donatorët dhe OJQ-të;
8. Është përgjegjës për edukimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF-së;
9. Është përgjegjës për vendosjen e mekanizmave të sigurimit të cilësisë së punës në insitucionin e QKMF-së;
10. Është përgjegjës për dhënjen e kontributit për zhvillimin e Sistemit të Informimit Shëndetësorë, të informatave dhe avancimin e punës ekipore;

11. Drejtori i QKMF-së për kryerjen e punëve të tij i përgjigjet drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Kryetarit të Komunës;

Kushtet dhe Kualifikimi:

Kandidati/ja të cilët konkurojnë për këtë pozitë përveq kushteve të përgjithëshme të parapara me Ligj duhet të kenë të përfunduar :

- Fakultetin e Mjekësisë - Mjek specialist i Mjekësisë Familjare,
- Licencën e punës,
- 5 vite përvojë pune.

Dokumentet e kërkuara:

- Kopja e Diplomës së Fakultetit - të vërtetuar,
- Kopjen e Licencës së Punës - të vërtetuar,
- Çertifikatën e Lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit,
- Çertifikatën që nuk është i dënuar dhe nën hetime,
- Çdo dokument tjetër apo çertifikatë trajnimi që kandidat-i/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kriterëve të përcaktuara më lartë,
- Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter e dëshirueshme.

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë pas kalimit të afatit prej 30 ditësh nga dita e shpalljes nga NJMBNJ në web faqe – SIBMNJ (shpallja nga data 21.06.2023 deri me datë 20.07.2023).

Konkursi mbetet i hapur: nga data 21.07.2023 deri me datë 29.07.2023 është afati 8 ditë kalendarike për marrjen dhe paraqitjen e aplikacioneve për poziten e shpallur.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, kati I, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyrë.

Me Kandidatët të cilët kanë konkuruar, do të mbahet intervista nga komisioni .

Për datën dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen me kohë.

Vërejtje: Aplikacionet të dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Vetëm kandidatet e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen.



Drejtor i DSH
Dr. Zepel Shatri

[Handwritten signature]